



Pranuar / Dorezuar Prilijeno/Pridata Received/Delivery	14.09.2022	2	viti god year
Organ /Njesia Org./Jedinica Org./Unit	SKIMSHCK	2131/2022	1/3
Nr Prot Br Prot Prot No		Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity



Republika e Kosovës

Republika Kosova – Republic of Kosovo

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës Nezavisni Nadzorni Odbor Civilne Službe Kosova Independent Oversight Board for the Civil Service of Kosovo

A.nr.195/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi Bajraktari-kryetare, Eshref Shabani dhe Jeton Koca -anëtarë, me Valentina Kaçandolli Bekteshi –Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën A.nr.195/2022 të datës 01.03.2022 të parashtruar nga ankuesja me adresë

kundër organit të punësimit Komuna e Mitrovicës, në çështjen juridike “vlerësim i punës”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nen paragrafin 1.1, nenin 18 paragrafin 1 nen paragrafin 1.3 dhe 1.4 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 14.04.2022, mori këtë:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET si e pa bazuar** ankesa A.nr.195/2022 e datës 01.03.2022, e parashtruar nga ankuesja
- II. **MBETETE NE FUQI**, vlerësimi i rezultateve në punë, për vitin 2021, për nëpunësen civile Lirije Muja Sadiku, nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë.
- III. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.
- IV. Vendimi hynë në fuqi në ditën e ndëshkimit nga Kryetarja e Kolegjit.

A r s y e t i m

Ankuesja me datë 01.03.2022 me numër protokolli 1092/2022, ka parashtruar ankesë nëpërmjet e-mail-it zyrtarë për parashtrimin e ankesave ankesa.kpmschck@ks-gov.net në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore lidhur me vlerësimin e bërë nga Shefi për Planifikim dhe Urbanizëm me datë 26.01.2022 ndaj ankuseses si Zyrtare për Buxhet dhe Financa në DPU pasi që vlerësimi është i pa pranuar dhe i pa konfirmuar nga ana e ankuseses, pasi që vlerësimi është shumë subjektiv dhe aspak i bazuar në objektivitet dhe po ashtu e konteston se vlerësimin e rezultatit të punës është dashtë ti bëhet nga Drejtori i Drejtorisë për Planifikim dhe Urbanizëm.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 07.03.2022, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Komuna e Mitrovicës. Ndërsa me datë 15.03.2022, Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë të ankueses me shkresat e bashkangjitura të lëndës faqe 1/16.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike dhe bazës juridike, për marrjen e vendimit meritot ka administruar këto prova: Ankesën e ankueses së datës 01.03.2022 të parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kërkesa për Komision Disiplinor e datës 03.02.2022; Formulari për vlerësimin e rezultatit të punës për vitin 2021; Akt emërimi i datës 24.07.2015; Përshkrimi i detyrave të punës për vendin e punës "Zyrtare për Buxhet dhe Financa 1"; Përgjigje në kërkesë e datës 04.02.2022 me referencë 01-116/01-000924-2/22; Organogrami i Organizimit të Drejtorisë; Vendimi i datës 30.12.2020; Vendimi datës 30.09.2021 si dhe përgjigja në ankesë nga organi i punësimit me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët dhe ka konstatuar se ankesa e ankueses
është e pa bazuar, sepse:

Kolegji, për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankueses lidhur me vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2021, pasi që ka shqyrtuar pretendimet ankimore, Kolegji ka konstatuar se pretendimet ankimore të ankueses nuk janë në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi.

Bazuar në vlerësimin e rezultateve në punë për ankuesen Kolegji konstaton se ankuesja është vlerësuar nga Shefi i Sektorit për Drejtori për Planifikim dhe Urbanizëm me notën e përgjithshme dy pike e shtatë (2.7), prandaj bazuar në vlerësimin për periudhën nga data 01.10.2021 deri me datën 31.12.2021 kur ankuesja është kthyer nga pushimi i lehonisë, vlerësimi i është bërë nga Shefi i Sektorit për Drejtori për Planifikim dhe Urbanizëm shihet nga shkresat e lëndës se ankuesja është vlerësuar me notën e përgjithëshomë "Mirë".

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka konstatuar se Shefi i Sektorit për Drejtori për Planifikim dhe Urbanizëm, në rastin e vlerësimit të rezultateve në punë për nëpunësin civil ka vepruar në pajtim me nenin 43 paragrafi 1, 2, 3 dhe 4 të Ligji nr. 06/l – 114 për Zyrtarët Publikë, ku përcaktohet: *"1. Vlerësimi i rezultateve në punë është proces i përhershëm, që përfshin vlerësimin e realizimit të objektivave të paracaktuar dhe vlerësimin e sjelljes profesionale të nëpunësit civil në realizimin e objektivave. Periudha e vlerësimit zgjat 1 vit dhe fillon nga 1 janari dhe mbaron më 31 dhjetor. Vlerësimi bëhet deri më 31 janar të vitit të ardhshëm, për vitin pasues. 2. Vlerësimi i rezultateve në punë bazohet në objektivat e paracaktuar në mënyrë individuale për nëpunësin që vlerësohet, në përputhje me përshkrimin përkatës të punës dhe objektivat e njësisë apo institucionit. 3. Objektivat paracaktohen me shkrim, në fillim të vitit, në muajin janar, së bashku me planin e veprimtarive për arritjen e objektivave. 4. Objektivat paracaktohen nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë, në bashkëpunim me nëpunësin dhe e bëjnë me dije atë".*

Duke u bazuar në provat e lëndë në formularin e vlerësimit të rezultateve në punë për periudhën nga data 01.10.2021 deri me datën 31.12.2021, për ankuesen e vlerësuar nga Shefi i Sektorit për Drejtori për Planifikim dhe Urbanizëm, si mbikëqyrës i drejtpërdrejtë del se ankuesja është vlerësuar me notën e përgjithshme dy pike, shtatë (2.7), Kolegji konstaton se



vlerësimi për periudhën nga data 01.10.2021 deri me datën 31.12.2021 është në pajtim me nenin 11 paragrafi 1 nën paragrafi 2.3 të Rregullores Nr. 21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike, ku përcaktohet se: **“1. Objektivat dhe sjelljet profesionale do të vlerësohen me nota nga 1 deri në 5. Rezultati përfundimtar i vlerësimit llogaritet në bazë të mesatares së marrë dhe paraqitur si në vijim: 2.3. “mirë”, vlerësohet nëpunësi, i cili ka realizuar të gjitha objektivat e punës, dhe ka treguar aftësi të pritshme të punës”** po ashtu Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka konstatuar se vlerësimi është bërë edhe në pajtim me nenin 10 paragrafi 1, 2, 3 dhe 4 të Rregullores Nr. 21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike, ku përcaktohet se: **“1. Vlerësimi për arritjen e objektivave të punës përbën 60% të rezultateve përfundimtare të vlerësimit, ndërsa vlerësimi i sjelljeve profesionale të nëpunësve civilë përbën 40% të rezultateve përfundimtare të vlerësimit. 2. Nota mesatare e objektivave kalkulohet duke mbledhur notat e të gjithë objektivave të vlerësuar dhe duke pjesëtuar me numrin e objektivave të vlerësuar. 3. Nota mesatare e sjelljeve profesionale (aftësive) kalkulohet duke mbledhur notat e të gjithë aftësive të vlerësuara dhe duke pjesëtuar me numrin e aftësive të vlerësuar. 4. Nota e përgjithshme kalkulohet duke mbledhur 60% (shumëzuar me 60 dhe pjesëtuar me 100) të notës mesatare të objektivave dhe 40% (shumëzuar me 40 dhe pjesëtuar me 100) të notës mesatare të aftësive.”**


Andaj bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin e ankesave pas analizimit dhe vlerësimit të gjitha shkresave të lëndës dhe provave të ofruara nga palët, si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda A.Nr.195/2022

Valentina Kaçandolli Bekteshi


Procesmbajtëse

Malsore GASHI BAURAKTARI



Vendimi i dërgohet:

- Ankuese;
- Kryetarit të Komunës së Mitrovicës;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Mitrovicës;
- Arkivit të KPMSHCK-së,

